



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

E.Rev.nr.1/2021

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Erdogan Haxhibeqiri, kryetar, Fejzullah Rexhepi dhe Zenel Leku, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses FHI “Z.” AD Leskovc, me seli në Republikën e Serbisë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Avdi Ahmeti, av. nga P., kundër të paditurës “E.” sh.p.k, me seli në Gj., të cilën e përfaqëson me autorizim Blerim Prestreshi, av. nga P., për shkak të borxhit, duke vendosur sipas revizionit të paditëses të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae.nr.170/2017 datë 09.12.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur më 04.08.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

Pranohet si i bazuar revizioni i paditëses, PRISHEN aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae.nr.170/2017 datë 09.12.2019, dhe i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike I.EK.nr 145/15 i datës 12.05.2017, dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae.nr.170/2017 datë 09.12.2019, është refuzuar ankesa e paditëses dhe është vërtetuar aktgjykimi Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike I.EK.nr.145/15 i datës 12.05.2017, me të cilin në pikën I të dispozitivit është refuzuar kërkesëpatria e paditëses, ku ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të borxhit t’ia paguaj paditëses shumën prej 220,216.00 €, me kamatë ligjore prej 8% , duke filluar nga data 26.03.2015, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në afatin prej 7 ditësh, nga dita e dorëzimit të aktgjykimit me kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Nën pikën II të dispozitivit, detyrohet paditësja që të paditurës t’ia paguaj shumën prej 1,226.00 €, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, në afat prej 7 ditësh me kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë në afat ligjor ka paraqitur revizion paditësja duke e goditur të njëjtin për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale me propozim që të dy aktgjykimet e cekura të gjykatave të instancës më të ulët, të ndryshohen dhe të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditëses.

E paditura ka paraqitur përgjigje në revizion, me propozim që revizioni i paditëses të refuzohet si i pabazë.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në bazë të nenit 215 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), ka gjetur:

Revizioni i paditëses është i bazuar.

Në procedurë të zhvilluar pranë gjykatës së shkallës së parë dhe në bazë të provave të administruara është vërtetuar se paditësja me të paditurën kanë lidhur marrëveshje, për furnizimin e paditëses me produkte farmaceutike. I padituri edhe pse furnizohej nga paditësja në mënyrë të rregullt dhe sipas porosive kishte detyrime të pashlyera ndaj paditëses në shumë prej 220.216.00 euro. Më datën ..., në mes të "E." sh.p.k nga Gj. (si_asignat), "D. H. C." sh.p.k nga K. (si asignat), dhe FHI "Z." Ad Leskovc Republika e Kosovës (si asignator), është lidhur kontrata e Asignimit, ku i padituri është pajtuar që borxhi i tij i pashlyer ndaj FHI Z. t'ia paguhet nga D. H. C. sh.p.k nga K. si asignat, ndërsa në nenin 3 të kontratës së asignimit ishte paraparë që D. H. C. sh.p.k K., të paguaj në llogarinë e paditëses në gjashtë këste mujore nga 37,3470.00 euro, po ashtu në të njëjtën kontratë në nenin 6 është paraparë që në rast se D. H. C. (Asignat) nuk e përmbushë pagesën në llogari të asignatorit, në afatin e definuar në nenin 3 të kësaj kontrate, Assignatori rezervon të drejtën e kërkesës ndaj asignantit, përkatësisht ka të drejtë të kërkoj pagesën e kërkesës nga neni 2 i kësaj kontrate nga asignanti, dhe mbi këtë bazë ka kërkuar që të detyrohet e paditura që t'ia paguaj detyrimin ndaj paditëses.

Në bazë të kësaj gjendje të vërtetuar faktike, gjykata e shkallës së parë ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses nga fakti se në këtë çështje juridike kemi të bëjmë me objekt të kontratës, me sendin që është jashtë qarkullimit juridik në territorin e Republikës së Kosovës dhe se gjykata nuk mund të afrojmë mbrojtje gjyqësore të një kontrate e cila për objekt ka sendin që është jashtë qarkullimit juridik, gjegjësisht e cila kufizohet në qarkullim me dispozitat caktuar juridike.

Gjykata e shkallës së dytë duke vendosur sipas ankesës së paditëses me aktgjykimin e saj e ka refuzuar ankesën e paditëses dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë duke pranuar në tërësi konstatime faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, duke gjetur se ajo ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plot gjendjen faktike në bazë të cilës ka zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës tani për tani nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët, si të drejtë dhe të ligjshëm ngase se sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i goditur dhe ai i shkallës së parë janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182.2 (n) të LPK dhe me zbatim të gabuar të drejtës materiale, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me shkelje thelbësore të parashikuara me nenin 194 dhe 204 të LPK, për çka aktgjykimet pa tjetër u dashtë të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore qëndrojnë në faktin se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është në kundërshtim me arsyet e dhëna si dhe rreth përmbajtjes së dokumenteve-provave që gjinden në shkresat e lëndës. Kjo shkelje konsiston në faktin se gjykata e shkallës së dytë e refuzon ankesën e paditëses dhe vërteton aktgjykimin e shkallës së parë dhe se gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses, nga fakti se objekti i kontratës kanë qenë sendet në qarkullim të kufizuar juridik, dhe medikamentet medicinale të cilat e paditura i ka blerë nga paditësja nuk kanë përmbushur kushtet për të vënë në treg për shkak se këto mallra kanë pasur CPP e falsifikuara. Paditësja nuk ka paraqitur asnjë provë se për këto të meta juridike, ka lajmëruar të paditurën.

Dispozita e nenit 495 Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve 04/L-077, detyron blerësin që në afat prej 1 viti të njoftoj shitësin për të meta juridike të sendeve dhe se kjo e drejtë shuhet në afat prej 1 viti, nga dita kur blerësi ka kuptuar për të metat juridike të sendeve, në rastin konkret mungesën e licencës (CPP), për produkte të cilat ka blerë nga paditësja, ky fakt relevant juridik nuk është vlerësuar nga gjykatat e instancave më të ulëta.

Palët ndërgjyqëse kanë qenë në raporte afariste, sipas të cilave paditësja, të paditurën në kontinuitet e ka furnizuar me produkte medicinale, ashtu që më datën ... , kanë lidhur aneksë kontratën me të cilën e paditura pajtohet se borxhi ndaj paditëses është në shumën prej 281.903,00 € dhe se para kësaj më datën ..., është lidhur edhe kontrata e asignacionit, në mes

të paditurës (si asignant) dhe D. H. C. (asignati) dhe të paditëses (si asignator), ku D. H. C., ka pranuar që borxhin e pashlyer të paditurës në shumën prej 224,082.00 të paguaj D. H. C.". Nuk është vlerësuar fakti se nëse produktet medicinale me të cilat është furnizuar e paditura nuk kanë pasur licencën nga shitësi, këtu paditësja, pse janë lidhur me vonë aneks kontrata si dhe kontrata e assignacionit.

Gjykata e shkallës së parë konstaton se produktet medicinale që kanë qenë objekti i kontratës, kanë pasur CPP falsifikuar dhe për këtë shkak Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës nuk ka lejuar furnizimin dhe se janë pezulluar Çertifikatat e Marketingut, dhe se ky konstatim bazohet në email të kësaj Ministrie, ndërsa nuk ka vendim të MSH si dhe Agjencionit Kosovës për Produktet Medicinale (AKPM) për ndalimin e produkteve të cilat kanë qenë objekti i kontratës së lidhur në mes palëve ndërgjyqëse.

Inspektorati Farmaceutik për Produkte dhe Pajisje Medicinale, në përgjigje të kërkesës së paditëses njofton se në verifikimin e stoqeve të produkteve–infuzioneve nga prodhuesi Z. A.D (këtu të paditëses), është kryer inspektimi dhe është konstatuar se stoku fizik i produkteve korrespondon me stokun e produkteve të paraqitura në kërkesë dhe kërkohet që stoku fizik të ruhet deri në krijimin e kushteve për shkatërrim, ndërsa nga gjykata e shkallës së parë nuk është vërtetuar se a kemi të bëjmë me produkte që kanë qenë objekt i kontratës, apo me produktet tjera medicinale.

Neni 23 u Ligjit NR.04/L -190 Për Produkte dhe Pajisje Medicinale par.1 përcakton *“se Produktet medicinale pa Licence Importi apo pa Autorizim Marketingu, duke përfshirë dispozitat e nenit 20 paragrafi 3 të këtij ligji, apo me cilësi të dyshuar, apo të falsifikuar, apo me afat të skaduar, ose të deponuar apo të përgatitur në kundërshtim me kushtet e përcaktuara me PMSH, apo dukshëm të dëmtuara ose të pa konsumuara tërësisht (me tej, “produkte medicinale te papërdorshme”), duhet të shkatërrohen, përfshirë paketimin e tyre, me qëllim të parandalimit të rrezikut për jetë dhe për shëndetin e njerëzve ose kafshëve apo për mjedisin”*. Prandaj, në vendosje të sërishme në këtë çështje juridike duhet të vërtetohet fakti se e paditura a ka njoftuar blerësin këtu paditësen për të metat juridike të produkteve medicinale të cilat kanë qenë objekt i kontratës në mes tyre dhe se a ka donjë vendim të organeve kompetente se produkte të cilat ka dërguar paditësja të paditurës nuk ka mundur nga AKPM të furnizohen me Autorizimet e Marketingut në bazë të Udhëzimit Administrative 01/2015 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për Autorizimin për Marketing për Produkte Medicinale, se produktet

të cilat kanë qenë objekti i kontratës nëse nuk kanë pasur CPP nga paditësja a janë shkatërruar nga organet kompetente në procedurat e përcaktuara me ligj dhe udhëzim administrativ.

Nga arsyet e dhëna u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 224.2 lidhur me nenin 505.1 të LPK.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTIË
E.Rev.nr.1/2021 me 4 gusht 2022

Kryetar i kolegjit,
Erdogan Haxhibeqiri